



Datë: 01.09.2025
Numër Protokolli: 5878/2025

A.nr.1271/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Sabile Avdyle, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1271/2025, të datës 02.07.2025, të parashtruar nga ankuesja A.G, kundër Komunës së Dragashit në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 01.09.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.1271/2025, e datës 02.07.2025, e parashtruar nga ankuesja A.G.

II. Mbetet në fuqi Njoftimi i datës 27.06.2025 i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Dragashit për kandidaten fituese sipas konkursit RN00017631 të datë 15.04.2025.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbimin civil, A.G (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*), me datë 02.07.2025, ka parashtruar ankesë, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit RN00017631 për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm për vendin e punës Zyrtar për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave klasa e pozitës Profesional 2 me pretendime ankimore kundër refuzimit të aplikacionit në fazën e verifikimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 18.07.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Dragashit, ndërsa kjo e fundit, me datë 23.07.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 4470/2025 e parashtruar nga ankuesja më datë 02.07.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aplikacionin e ankuese të datës 18.04.2025; Përgjigjen e datës 23.07.2024; aplikacionin e kandidatës fituese; Njoftimin për kandidaten fituese të datës 27.06.2025 Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokolli:4421/2025 të datës 27.06.2025; Zarin postar me shifër R8873991; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 30.05.2025; Përgjigje në Kërkesë e datës 10.06.2025; Konkursin e datës 26.02.2025; Listën e aplikantëve e datës 29.05.2025; Njoftimin e datës 08.04.2025; Vendimin e datës

08.06 të Kryetarit të Komunës dhe akt emërimet e anëtarëve të komisionit; Dosjen e ankuesit; Testin me shkrim për kandidaten fituese; Formularët e vlerësimit.

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lindës të ofruara nga palët në procedurë ka konstatuar se ankesa është e pranueshme dhe është lëshuar në shqyrtimin meritore të ankesës dhe, ka gjeturës ankesa e ankueses, është e **pabazuar**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se Komuna e Dragashit, më datë 15.04.2025 ka shpallur konkursin me numër reference RN00017631, për Grupi i Administrimit të Përgjithshëm, pozita “Zyrtar për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave”- Profesional 2”, në Drejtorinë për Administratë dhe Punë të Përgjithshme, ku afati për aplikim ka qenë nga data 16.04.2025 deri më 15.05.2025, ndërsa sipas shkresave të lëndës, fazën e verifikimit paraprak e kanë kaluar 12 kandidatë, ndërsa ankuesja nuk e ka kaluar fazën e verifikimit paraprak. Kolegji i Këshillit fillimisht ka konstatuar se konkursi i lartpërmendur është shpallur në harmoni me Rregulloren Nr.06/2024 për Klasifikimin e vendeve të Punës në Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në përputhje me katalogun e vendeve të punës e cila pozitë është evidentuar në nr.1154-SHC-1154.

Kriteret formale lidhur me këtë konkurs kanë qenë:

- **Arsimimi i kërkuar:** *Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor), Drejtimi –Juridik, Ekonomik(pa specifikim), Sociologji, Antropologji, Filozofi, Histori, Shkenca Politike, Psikologji, Punë Sociale, Gjeografi, Administratë Publike.*
- **Përvoja e punës e kërkuar:** *Së paku një (1) vite përvojë pune;*

Ankuesja në ankesën e parashtruar në KPMSHC me pretendimet sikur janë shënuar në hyrje të këtij arsytimi, Kolegji me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve të ankueses ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht Nenin 9 paragrafi 1, ku përcaktohet se: 1. Kriteret e përgjithshme që një person duhet t’i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t’u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik; 1.7. **të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës;** dhe 1.8. të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj”, dhe nenit 39 paragrafi 1, dhe 7, ku përcaktohet: 1. Pranimi në shërbimin civil bëhet në të gjitha kategoritë e shërbimit civil, nëpërmjet një procedure rekrutuese të hapur dhe publike, përveç kur parashikohet ndryshe me këtë ligj. **7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit;** dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve.

Po ashtu Kolegji ju referua, Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, respektivisht nenit 6 paragrafi 2 të, ku përcaktohet se: 2. Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e rekrutimit, kandidatët duhet të bashkëngjisin edhe dokumentacionin në vijim: 2.1. kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs e të dhëna nga institucionet arsimore, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar jashtë vendit apo aktin që dëshmon se diploma e fituar jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë; 2.2. kopjet e dëshmisë së punësimit; 2.3. kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion.

Ndërsa, sipas nën pikës 2, 3 dhe 5 të pikës 5 të konkursit të datës 21.03.2025, rezulton se dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit, janë përcaktuar si në vijim: 2. *Kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs të lëshuar nga institucionet arsimore të Republikës së Kosovës. Nëse diploma është fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë.* 3. *Kopjet e dëshmisë së punësimit (vërtetim/kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen dhe angazhimin në atë pozitë.*

Kolegji i Këshillit, sjellë në vëmendje ankueses se Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, me rastin e nxjerrjes së Vendimit të datës 29.05.2025, përmes të cilit akt ka refuzuar aplikacionin e ankueses ka vepruar në pajtim me dispozitat e lartë theksuar ligjore dhe kërkesat e përgjithshme formale të konkursit përkatës, pasi që sipas shkresave të lëndës të bashkëngjitura nga organi i punësimit respektivisht Komuna e Dragashit ankuesja ne aplikacionin e saj sa i përket përvojës së punës ka bashkëngjitur faqen e parë të marrëveshjes për Angazhim në Masën Aktive të Tregut të Punës, dhe nuk ka asnjë të dhënë tjetër në këtë marrëveshje ashtu siç kërkohet në konkurs, gjithashtu ka bashkëngjitur një referencë nga Gjykata Themelore Prizren dega ne Dragash, por e cila nuk sqaron kohën se sa kohë ka kryer praktikë (Kolegji tërheq vëmendjen se ankuesja në ankesën e saj e ka bashkëngjitur certifikatën për përfundimin e praktikës 1 vjeçare, por nga shkresat e lëndës të dorëzuar nga K-Dragash kjo certifikata nuk është në shkresat e lëndës), prandaj Kolegji konstaton nisur nga dispozitat e lartshënuar se NJMBNJ e Komunës së Dragashit drejtë ka konstatuar gjendjen faktike dhe juridike kur ka refuzuar aplikacionin e ankueses duke u nisur nga shkresat e lëndës.

Kolegji me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së këtij procesi ka analizuar edhe dosjen e kandidates që është shpallur fituese në konkursin e lartshënuar dhe ka konstatuar se kandidatja E.M posedon diplomën me Nr.5853 të datës 22.05.2019 me të cilën dëshmohet se ka diplomuar me datë 13.04.2025 dhe mori titullin Jurist i diplomuar-Bachelor dhe me përvojë të punës sipas kontratës së punës të datës 21.01.2021 deri më datë 31.12.2022 në kompaninë Dreni në pozitën Administratore (të mbuluar me pasqyrën e trustit); Certifikatën e datës 31.01.2024 me të cilën dëshmohet se ka përfunduar praktikën e punës në Gjykatën Themelore të Prizrenit dega në Dragash nga data 01.02.2023 deri me datë 31.01.2024; Vendimit të datës 06.09.2024 02.nr.112/0224856/24 është emëruar në pozitën Zyrtare për Marrëdhënie me Publikun me mandat të njëjtë me Kryetarin dhe nuk ka dëshmi që ky vendim të jetë shfuqizuar

Andaj, duke marrë për bazë konstatimet e dhëna si më lartë, Kolegji i Këshillit vendosi sikurse në dispozitivin e këtij vendimi, ashtu që refuzoi ankesën e ankueses të datës 02.07.2025.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 132 paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1271/2025,

Sabile Avdyli

Procesmbajtëse

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit A.G;
- Komunës së Dragashit (Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore), si dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.